



Ilustrim

Pejë - Arrestohet pasi gjuan me armë



Egzon Dahsyla

12.11.2019 - 11:54

Policia e Kosovës ka njoftuar se në rrugën 'Konstandtini i Madh' në Pejë është arrestuar një person për gjuajtje me armë zjarri, armëmbajtje dhe posedim të drogës.

Sipas njoftimit, fillimisht është raportuar për të shtëna me armë zjarri, ku policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe aty ka takuar ankuesin i cili ka raportuar se një plumb ka goditur murin e shtëpisë së tij.

Në lidhje me ngjarjen, është arrestuar fillimisht një person i dyshuar, ku pastaj me urdhër të prokurorit është kontrolluar shtëpia e tij, dhe i është gjetur një sasi e vogël e drogës dhe një armë 'Zoraki' 6 mm, një predhë dhe një fishek.



Sipas policisë, i dyshuari është dërguar në mbajtje.

Ngjarja ka ndodhur të hënën rreth orës 17:40.

Kryesore



Rangimi i ri, 7 komuna në zonë të kuqe deri më 15 janar

COVID-19

08.1.2021

LAJMI I FUNDIT

Dënuan qytetarin me ligj të Serbisë, suspendohen dy policë të Kosovës në Novobërdë

INSPEKTORIATI I POLICISË




Situata e rënduar nga vërshimet, Hoti thotë se do angazhohet edhe FSK-në në rast nevoje

AVDULLAH HOTI



Gani Geci: Vrasës me pagesë nga Shqipëria kanë pranuar ofertë për të më vrarë

GANI GECI



Familjari akuzon: Babai me vdiq, ambulanca nuk pati oksigjen - VIDEO

EMERGENCA

Të Fundit



Aksident me lëndime në Fushë Kosovë

AKSIDENT TRAFIKU

08.1.2021



Trump nuk do të marrë pjesë në inaugurimin e Bidenit